



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN
NDËRKOMBËTARE “ROLI I DECENTRALIZIMIT NË KONSOLIDIMIN E
DEMOKRACISË NË SHQIPËRI DHE INTEGRIMI EVROPIAN”**

30 tetor 2012

I nderuar Ministri Noka,
Të nderuar anëtarë të panelit,
Zonja dhe zotërinj,

Lejomëni t’ju them, në fillim, se sa i kënaqur jam të shoh kaq shumë fytyra të njohura këtu, nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë, çka tregon që decentralizimi është çështje me rëndësi.

Në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, do të doja t’u bashkohesha atyre që, me të drejtë, falënderuan organizuesit për këtë konferencë ndërkombëtare të rëndësishme, që vjen në kohën e duhur, të përqendruar në procesin e decentralizimit në konsolidimin e reformave demokratike në Shqipëri.

Misioni që unë drejtoj, i bazuar në mandatin e tij, mbështet përpjekjet kombëtare që synojnë promovimin e qeverisjes së mirë dhe praktikave më të mira në fushën e decentralizimit, fuqizimin e demokracisë vendore përmes zbatimit të Kartës Evropiane dhe vënies në jetë të parimeve të qeverisjes së mirë, këtu në Shqipëri.

Prezenca e OSBE-së i ka ndihmuar njësitë e qeverisjes vendore në forcimin e kapaciteteve të tyre, si një parakusht për sigurimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të komuniteteve të tyre. Në sytë tanë, kjo është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat themelore të njeriut.

Ja përse Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i përqendron përpjekjet në promovimin e pjesëmarrjes publike në përgatitjen e vendimmarrjes, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave dhe grupeve të cenueshme, si dhe mundësisë për të marrë informacion.

Autonomia vendore mundëson vënien në jetë të së drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse, veçanërisht në fusha dhe çështje që i prekin më së shumti në jetën e tyre të përditshme.

Autoritetet vendore kanë përgjegjësi të rëndësishme që të ofrojnë shërbime në mënyrë efikase dhe t’u përgjigjen nevojave dhe problemeve të qytetarëve të tyre.

Në këtë drejtim, parimet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore përcaktojnë që autoritetet vendore janë një nga shtyllat kryesore të çdo shoqërie demokratike dhe theksojnë rëndësinë e së drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në zhvillimin e çështjeve me interes publik.

Këto janë parime demokratike themelore, të cilat i kanë bërë të tyret Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, me të cilat bashkëpunojmë për këtë qëllim.

Një nivel i përparuar i autonomisë vendore mund ta ndihmojë vendin në arritjen e standardeve të nevojshme në të mirë dhe shërbim të qytetarëve të tij.

Kjo kërkon autoritete vendore të pajisura me organe vendimmarrëse të krijuara në mënyrë demokratike. E mira është që këto organe të zotërojnë edhe një nivel të lartë autonomie sa u përket zgjidhjeve në fushat e tyre të përgjegjësisë.

Shumë është arritur në këtë fushë. Prandaj, unë dëshiroj ta përshëndes progresin e bërë në Shqipëri deri tani.

Megjithatë, mbetet ende një punë e konsiderueshme për t'u bërë si në nivel qendror, ashtu edhe vendor, në mënyrë që të gjitha angazhimet të mund të konkretizohen e të kthehen në vepra.

Që të ndodhë kjo, nevojitet, së pari, vullnet i mirë politik mes gjithë aktorëve për të çuar përpara reformat e nevojshme, duke përfshirë parashikimin e fondeve të mjaftueshme për këtë proces.

Unë shpresoj se do të shohim nivelin e lidërshit që kërkohet për arritjen e këtyre qëllimeve dhe për përballimin e sfidave aktuale, në të mirë të qytetarëve.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të ritheksoj se Prezenca e OSBE-së mbetet e angazhuar për ta mbështetur dhe forcuar këtë proces, që ai të prodhojë përfitime të prekshme.

Më lejoni t'ju uroj të gjithëve një konferencë shumë frytdhënëse.

Faleminderit!

Fund